

Të këndojmë të lavdërojmë Perëndinë (5:19–20)

Më kujtohet kur isha në shkollë fillore e kishim shkuar në një kamp lart në mal. Ishte një natë e ftohtë. Dielli kishte perënduar dhe ishte errësirë. Ndërsa po ecnim në një monopat të ngushtë, kishim ndezur elektrikët e dorës. Udhëtimi ynë përmes pemëve përfundoi në një vend të hapur, ku udhëheqësit tanë kishin ndezur një zjarr. U ulëm të gjithë përreth zjarrit dhe shikonim shkëndijat që ngriheshin lart dhe zhdukeshin me tymin. Ngrita kokën dhe pashë aq shumë yje sa nuk më kishin zënë sytë më parë. Pastaj dëgjova ujin e një burimi të vogël që gurgullonte aty pranë. Aroma e mrekullueshme e pishave mbushte ajrin dhe akoma mund të dëgjoj vargjet e një kënge që kënduam atë natë:

O Zoti im! Kur mendoj i mahnitur,
I marr me mend gjith'punët e dorës sate,
Yjtë në qiell, shkrepetimat e fuqishme,
Fuqia jote shfaqet kudo në gjith'si.

Shpirti im t'këndon, o Zot, Shpëtuesi im,
Sa i madh je Tij, sa i madh je Ti!

Më kujtohet si tani se, ndërsa këndoja atë natë, mendoja me vete: «Ndihem si në shtëpi». Ndoshta lart në një mal të errët, shumë larg shtëpisë sime dhe larg tingujve të njohur të fëmijërisë sime. Megjithatë, e ndieja në zemër, thellë në vete, se në njëfarë mënyre gjatë këndimit të asaj kënge ndihesha në shtëpi.

Vajza ime Sara është si të gjitha vajzat e tjera

adoleshente. Çdo mëngjes ajo rregullon flokët. Një ditë, ndërsa po haja mëngjes, Sara po rregullonte flokët. Tharësja e flokëve po bënte shumë zhurmë, por një tingull tjetër më bëri që të ndaloj e të dëgjoj. Ishte një zë i pastër dhe i drejtuar ndaj Perëndisë. Vajza ime po këndonte: «Jezus, Ti je Qengji i Perëndisë. Lavdëruar qoftë emri yt.»

Dëgjoja këngën e vajzës sime dhe mendoja: «Ndihem si në shtëpi». Këtë ndjenjë nuk e kisha sepse isha ulur në kuzhinën e shtëpisë sime, apo se familja ime ishte përreth meje. Ndjenja ime kishte të bënte me këngën, me muzikën që dilte nga një zemër plot dashuri për Perëndinë.

Shumë kohë më parë, dy burra kaluan natën në një qeli burgu. Atë ditë armiqtë e tyre kishin gënjyer në lidhje me ta dhe i kishin rrahur. Dy burrat ishin të uritur dhe të etur. Megjithëse ishte mesnatë, ata ishin aq të uritur saqë nuk mund të flinin dot. Për këta dy burra na tregohet te Veprat: «Aty nga mesnata Pali dhe Sila po luteshin dhe i këndonin himne Perëndisë; dhe të burgosurit i dëgjonin» (Veprat 16:25). Ata po këndonin edhe pse ishin në burg, edhe pse kishin dhimbje. Ata lavdëronin Perëndinë, ndërsa të burgosurit e tjerë dëgjonin dhe habiteshin se sa gëzim mund të kishte në një burg të errët. Kur lexoj për Palin dhe Silën mendoj: «Ata ndiheshin si në shtëpi atë natë, kënga i çonte më pranë Perëndisë.»

Ndjenja e të qenit në shtëpi, kur i këndojmë këngë Perëndisë, ka edhe më shumë kuptim kur

lexojmë Fjalën e Perëndisë: «Dhe mos u dehni me verë, në të cilën ka shturje, por mbushuni me Frymë» (5:18). Kur kristianët e pranojnë Perëndinë dhe i binden Atij, Fryma e Shenjtë i mbush ata. Prezenca e tij na jep energji dhe na transformon. Pra, Fryma e Shenjtë banon në ne.

Çfarë ndodh kur Fryma e Shenjtë banon në ne? Një pasojë e dukshme është të kënduarit ndaj Perëndisë me zemër të hapur. Pali shkroi:

Dhe mos u dehni me verë, në të cilën ka shturje, por mbushuni me Frymë, duke i folur njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj, duke e falënderuar vazhdimisht për çdo gjë Perëndinë dhe Atin, në emër të Zotit tonë Jezu Krisht (5:18–20).

Të jesh «i mbushur me Frymën» do të thotë të këndosh këngë ndaj Perëndisë, do të thotë të ndihesh si në shtëpi kur këndon apo dëgjon këngë që i këndohen Perëndisë.

Te Efesianëve 5:19–20 flitet për të kënduarit. Vini re me kujdes se çfarë thonë në përgjithësi këto vargje për çështjen e adhurimit me këngë.

ADHURIMI ME KËNGË

Adhurimi me këngë është *frymëror*. Ai vjen si rezultat i banimit të Frymës në ne. Vjen kur Fryma e Perëndisë prek frymën tonë. Të kënduarit nuk kërkon që të dimë të lexojmë notat e muzikës apo të arrijmë të këndojmë me melodinë e duhur. Adhurimi me këngë ndodh sepse Fryma e Perëndisë punon në ne.

Adhurimi me këngë është gjithashtu *plot emociione dhe prekës*. Bibla na tregon që t'i këndojmë Perëndisë me zemër. Në qoftë se nuk prekemi emocionalisht kur këndojmë, diçka nuk shkon. Adhurimi me këngë është më shumë se një përvojë intelektuale. Ai na bën të kemi ndjenjat më të forta.

Adhurimi me këngë është *gëzimplotë*. Nuk mund t'i lexojmë fjalët e Palit te Efesianëve 5 pa ndjerë gëzimin, gjallërimin dhe lavdërimin që shoqërojnë të kënduarit. Te Psalmeve 145:7 thuhet: «Ata do të shpallin kujtimin e mirësisë sate të madhe dhe do të këndojnë me gëzim drejtësinë tënde.»

Kemi shumë për të festuar në Krishtin! Ai na e mësoi këtë te shembëlltyra e djalit plangprishës. Ati i shpjegoi vëllait të madh se pse po bëhej gjithë ajo festë për kthimin në shtëpi të djalit të humbur: «O bir, ti je gjithmonë me mua, dhe çdo gjë që kam është jotja. Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse ky vëllai yt kishte vdekur dhe u kthye në jetë,

kishte humbur dhe u gjet përsëri» (Luka 15:31–32).

Festimet tona duhet të kryhen me respekt dhe përujle në prani të Perëndisë së madhërishëm. Megjithatë, respekti nuk duhet të barazohet me përjashtimin e entuziazmit. Perëndia ynë është i gjallë! Perëndia ynë banon në kishën e Tij! Fryma e Shenjtë mbush jetën tonë! Le të gëzojmë e të kënaqemi! Adhurimi me këngë është gëzimplotë.

Adhurimi me këngë është *shprehës*. Ai nderon Perëndinë. Këngët tona i kushtohen nderimit të Perëndisë. Fryma jonë drejtohet drejt Frymës së Tij.

Adhurimi me këngë është *kolektiv*. Ne kemi privilegjin të këndojmë së bashku me kristianët e tjerë, «duke i folur njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore». Të kënduarit na ofron një mundësi të bashkojmë zemrat dhe zërat me njëri-tjetrin. Kur këndojmë së bashku ka diçka më të veçantë se sa kur këndojmë vetëm. Shpesh i këndoj Perëndisë i vetëm. Mund të këndoj këngën: «Të dua Perëndi» dhe kjo shpreh dashurinë time ndaj Perëndisë. Kur këndoj bashkë me kristianët e tjerë, kënga merr dimensione të reja, duke konfirmuar se unë jam pjesë e diçkaje më të madhe se vetja ime apo fjalët e mia. Unë bëj pjesë në grupin e kristianëve që kanë të njëjtin besim që kam edhe unë.

Së fundi, adhurimi me këngë është shprehje e *mirënjohjes*. Një njeri që s'i këndon kurrë buza, nuk ka dëshirë të këndojë. Kur Fryma e Perëndisë vjen brenda nesh për të na ndryshuar zemrat, këndojmë këngë që shprehin mirënjohjen dhe gëzimin tonë.

Fjalët e Palit na mësojnë për adhurimin me këngë. Mendoni për to dhe për adhurimin që bëni me këngë. A përshkruhet adhurimi juaj me fjalë të tilla si «frymëror», «prekës», «gëzimplotë», «shprehës» dhe «mirënjohës»? Në fakt, këto duhet të jenë fjalët që përshkruajnë adhurimin që bëni me këngë.

ADHURIM NGA NJË ZEMËR E MBUSHUR ME FRYMËN

Vini re disa rezultate që vijnë si rrjedhim i të genit i mbushur me Frymën, ndërsa adhurojmë me këngë. *Së pari, duke qenë të mbushur me Frymën, ne kërkojmë t'i shërbejmë njëri-tjetrit*. Te vargu 19a thuhet: «Duke i folur njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore». Kristianët nuk jetojnë të veçuar nga njëri-tjetri. Ata kanë nevojë për njëri-tjetrin. Kur mblidhemi të këndojmë së bashku kujtojmë se kemi nevojë për njëri-tjetrin. Kur i

ngremë zërat së bashku drejt Perëndisë, kjo është një mënyrë me të cilën unë të shërbej ty dhe ti më shërben mua. Unë këndoj së bashku me ty këngë që shprehin besimin tënd dhe ti këndon së bashku me mua për mesazhin që zemra ime me dëshirë i dërgon Perëndisë. Duke e bërë këtë për njëri-tjetrin shërbimi ynë i ngjan shërbimit vetëmohues që bëri Jezusi ndaj të tjerëve.

Së dyti, duke qenë të mbushur me Frymën kërkojmë të adhurojmë Zotin Jezus. Te vargu 19b thuhet: «...duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj." Duhet të mbajmë një ekuilibër në të kënduarit tonë. Shumë këngë kanë mesazhe që u drejtohen atyre që janë përreth nesh, vëllezërve dhe motrave kristianë apo njerëzve të kësaj bote. Perëndia do që ne t'i këndojmë njëri-tjetrit, por gjithashtu duhet të këndojmë edhe këngë të tilla si «Kam nevojë për Ty në çdo moment" apo «Të gjunjëzuar para Teje", me të cilat i këndojmë Perëndisë me zemër.

Së treti, duke qenë të mbushur me Frymën ne i jemi mirënjohës Perëndisë për çdo gjë. Te vargu 20 thuhet: «Duke e falënderuar vazhdimisht për çdo gjë Perëndinë dhe Atin." Maks Anders shkroi për falënderimin:

Në qoftë se do ta kuptonim se sa me rrezik është ekuilibri i jetës sonë ndërsa e jetojmë atë përditë...në

qoftë se do ta kuptonim se sa e fuqishme është beteja shpirtërore përreth nesh...në qoftë se do ta kuptonim se sa me fat jemi që kemi bukë në tavolinë dhe një çati ku të fusim kokën...në qoftë se do ta kuptonim se sa shumë kemi nevojë për hirin e Perëndisë dhe për mirësinë e të tjerëve, që nevojat tona kryesore në jetë të plotësohen... do të ishim njerëz mirënjohës. Do të ishim mirënjohës për atë që kemi, në vend që të ishim mosmirënjohës për atë që nuk kemi.

Si do ta përshkruanit tonin e jetës suaj? Jeni njerëz që nuk u këndon buza kurrë apo jeni njerëz që u këndon zemra për Perëndinë? A ankoheni për diçka në shërbimin e adhurimit apo këndonin së bashku me motrat e vëllezërit në Krisht? A është zemra juaj e ftohtë apo është e ngrohur nga këngët që i këndonin Perëndisë?

KONKLUZION

«Mbushuni me Frymë, duke i folur njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj, duke e falënderuar vazhdimisht për çdo gjë Perëndinë, Atin, në emër të Zotit tonë Jezu Krisht.» Le të këndojmë himne që dalin nga zemra e mbushur me Frymën. Le të këndojmë këngë që shprehin besimin tonë, të cilin e ndajmë me të tjerët. Le të këndojmë muzikë që na sjell pranë zemrës së Perëndisë dhe na bën të ndihemi si në shtëpi.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: "Efesianëve"
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara